



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 25
15 qershor – 21 qershor 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	28 / 28	100%
		Librazhd	10 / 12	83%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%

SHKODËR		M. Madhe	6 / 6	100%
		Pukë	10 / 11	91%
		Kukës	13 / 14	93%
	Kukës	Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
		Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
	Lezhë	Mirditë	6 / 6	100%
		Vlorë	22 / 22	100%
VLORE	Vlorë	Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
		Fier	20 / 20	100%
	Fier	Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 6	100%
		Gjirokastrë	21 / 21	100%
	Gjirokastrë	Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	425 / 429	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 25

	JAVA 25
Diarre pa gjak	2001
Diarre me gjak	0
Infeksione respiratore të sipërme	6158
Infeksione respiratore të poshtme	2227
Rash me temperaturë	28
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i njësive raportuese	425
% e Njësive raportuese	99% (425/429)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:

Tiranë – 11 raste



Fier– 2 raste

Vlorë – 8 raste



Mat – 2 raste

Pogradec – 3 raste

Dibër– 2 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve.**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grupmoshave.**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 25 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 24.



Grafiku 3. Trendi në kohë i diarreve pa gjak sipas javëve.**Grafiku 4. Shpërndarja e diarreve pa gjak sipas grup-moshave**

Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 25 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 24.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 05 – 25 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 25 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000).**Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 24/2026 dhe 25/ 2026. Incidenca (raste/10.000).**


Vërehet një rritje e lehtë e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa gjak” në javët 05-25 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.



Në javën 25 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i lartë i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 24-25 2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Durrës, Bulqizë, Dibër dhe Vlorë ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthimi i sëmundjes Ebola i shkaktuar nga virusi Bundibugyo – Republika Demokratike e Kongos dhe Uganda – 2026

- Deri më 18 qershor 2026, në Republikën Demokratike të Kongos janë raportuar gjithsej 875 raste të konfirmuara, përfshirë 202 vdekje të konfirmuara (një rritje prej 40 raste të reja dhe 4 vdekje të reja krahasuar me raportimin e mëparshëm). Rastet janë raportuar në provincat Ituri, Kivu i Veriut dhe Kivu i Jugut. Në Ugandë janë raportuar gjithsej 19 raste të konfirmuara, përfshirë 2 vdekje.
- Më 17 maj 2026, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) shpalli se shpërthimi i sëmundjes Ebola i shkaktuar nga virusi Bundibugyo përbën një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare (PHEIC). Më 18 maj 2026, Qendra Afrikane për Kontrollin dhe Parandalimin Control and Prevention e shpalli këtë situatë një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Kontinentale (PHECS)
- Bazuar në informacionin aktual dhe pasiguritë që lidhen me zhvillimin e këtij shpërthimi, rreziku i infektimit për qytetarët e Shqipërisë dhe Europës që jetojnë ose udhëtojnë në zonat e prekura vlerësohet i ulët. Për popullatën që jeton në Europë, mundësia e infektimit vlerësohet shumë e ulët, për shkak të probabilitetit shumë të ulët të importimit të rasteve dhe transmetimit dytësor.
- Ky vlerësim rreziku do të rishikohet në varësi të të dhënave të reja epidemiologjike dhe zhvillimit të situatës.
- Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) dhe ISHP po monitoron shpërthimin përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemiologjike dhe po bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e informacionit dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut.

Njëkohësisht çdo person që udhëton nga DRC dhe Uganda për në Shqipëri i nënshtrohet më pas vetëkarantinimit dhe vetëmonitorimit për 21 ditë.

Gripi i shpendëve A(H9N2) – Monitorimi i rasteve humane

- Më 15 qershor 2026, autoritetet e Hong Kongut dhanë një përditësim për një rast të raportuar më parë më 12 qershor. Rasti u konfirmua se ishte infektuar me virusin e gripit të shpendëve A(H9N2), pa u identifikuar ndryshime të rëndësishme gjenetike të virusit.
- Pacienti është një fëmijë, pa sëmundje shoqëruese të njohura, i cili shfaqti simptoma të lehta më 9 qershor 2026 dhe vazhdon të jetë i izoluar dhe i shtruar në spital.
- Dyshohet se pacienti ka pasur ekspozim ndaj shpendëve të gjalla në një treg.
- Marrja e mostrave mjedisore ka evidentuar praninë e virusit A(H9) në një pikë tregtare që ishte vizituar nga pacienti.
- Nuk janë identifikuar raste të tjera ndër kontaktet e afërta të pacientit.
- Rreziku për shëndetin e njeriut në Shqipëri dhe Europë vlerësohet shumë i ulët.

Survejanca sezonale e infeksioneve nga Virusi i Nilit Perëndimor (WNV) – 2026

- Në Evropë, që nga fillimi i vitit 2026 dhe deri më 17 qershor 2026, dy vende kanë raportuar gjithsej 3 raste humane me infeksion nga Virusi i Nilit Perëndimor (WNV):

- Italia
 - Maqedonia e Veriut
- Aktualisht janë identifikuar 3 zona të prekura në Europë nga transmetimi lokal i infeksionit.
- Në Shqipëri janë dyshuar 10 raste të cilat nuk janë konfirmuar.
- Infeksioni nga Virusi i Nilit Perëndimor është një sëmundje e detyrueshme për raportim në nivel të Bashkimit Evropian, dhe rastet duhet të raportohen nga autoritetet kombëtare të shëndetit publik përmes platformës EpiPulse Cases, sipas përkufizimit të rastit të BE-së.
- Në përputhje me direktivat e Komisionit Evropian për sigurinë e gjakut (2004/33/EC dhe 2014/110/EU), institucionet e transfuzionit në Shqipëri dhe Europë duhet të zbatojnë shtyrjen e përkohshme të dhuruesve të gjakut alogjenik për 28 ditë pas largimit nga një zonë me transmetim lokal të WNV, përveç rasteve kur një test individual i acidit nukleik (NAT) rezulton negativ.
- Aktivitetet e survejancës së WNV të kryera nga ISHP dhe ECDC mbështesin autoritetet përgjegjëse për sigurinë e gjakut në zbatimin e këtyre masave.
- Kushtet sezonale të motit janë aktualisht të favorshme për transmetimin e sëmundjes nga mushkonjat, prandaj priten raste të konfirmuara apo një rritje e numrit të rasteve në javët në vijim në Europë.